

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.3 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 08.07.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja e Punës së Bordit Drejtues të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, e përgatitur sipas bazës ligjore dhe statutit të OIRK-së.
2. Autorizohet Kryetari i OIRK-së për të realizuar pagesën ndaj biznesit të avokaturës Muhamet Mujaj B.I., për shërbimet profesionale të përpilimit të kësaj rregulloreje, në vlerën 450 euro, si oferta më e favorshme ndër tre ofertat e pranuar.

Ofertat e pranuar ishin:

1. Muhamet Mujaj B.I. – 450 euro
2. Global Legal Business – 680 euro
3. Prudencia – 1500 euro

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.



Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 5 pika 5.3 të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenit 24 par.1 pika 3 të Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për Periudhën e Përkohshme me Nr. të Prot. 8648/24 të datës 31.12.2024, Bordi Drejtues i OIRK me datë 08.07.2025 miraton:

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT DREJTUES

NENI 1 QËLLIMI

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat e punës së funksionimit të Bordit Drejtues, mënyra e marrjes së vendimeve, përbërja, kryesimi, vendosja dhe çështje të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me punën e Bordit Drejtues.

NENI 2 BAZA LIGJORE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

1. Bordi Drejtues është organ i Odes së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) që kryen përgjegjësitë sipas Ligjit për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve dhe Statutit të OIRK-së.

NENI 3 PËRBËRJA E BORDIT DHE ZGJEDHJA E KRYETARIT

1. Bordi Drejtues përbëhet nga tetë (8) anëtarë, prej të cilëve shtatë (7) anëtarë të zgjedhur nga kuvendi i Odës me mandat 3 vjeçar dhe drejtori ekzekutiv i Odës i cili është anëtar pa të drejtë vote me mandat 4 vjeçar.
2. Kryetari i Odës zgjidhet nga Bordi Drejtues në mbledhjen e tij të parë, me shumicën e votave të anëtarëve të bordit, nëse ka vota të barabarta, vazhdohet me raundin e dytë, nëse rezultati vazhdon të jetë i njëjtë, zgjedhja bëhet me short dhe shortin e tërheq anëtar i më i vjetër i bordit për nga mosha
3. Në rast të shkarkimit të Kryetarit, Bordi Drejtues është i detyruar të procedojë me zgjedhjen e një Kryetari të ri, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit. Zgjedhja e Kryetarit të ri duhet të kryhet në përputhje të plotë me procedurën e parashikuar në nenin 3, pikën 2 të kësaj rregulloreje.
4. Anëtarët e zgjedhur të Bordit Drejtues nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës në favor të vetes gjatë procesit të zgjedhjes së kryetarit të bordit.
5. Mënyra e shkarkimit të Kryetarit të Odës dhe anëtarëve të tjerë të bordit drejtues është e rregulluar me Statut dhe i njëjti shkarkohet me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues në rast të:
 - a. pezullimit apo revokimit të licencës;
 - b. vendosjes së masës disiplinore për shkelje të rëndë;
 - c. shkeljes së rëndë të dispozitave të Statutit;
 - d. shkeljes së rëndë të vendimeve të Kuvendit ose Bordit Drejtues;

- e. neglizhencës apo mos-efikasitetit në ushtrimin e detyrës së kryetarit për zbatimin e programit të Odës;
- f. Mospërmbushja e vendimeve të Kuvendit apo Bordit Drejtues;
- g. Mos-përfaqësimi aktiv i Odës në takime zyrtare apo publike;
- h. Mungesë e komunikimit me organet dhe anëtarësinë;
- i. Mospërpilimi i raporteve, njoftimeve, planeve vjetore etj.;
- j. Mos-nënshkrimi i dokumenteve zyrtare në kohë;
- k. Lënia pas dore e zhvillimit të Odës dhe aktiviteteve të saj;
- l. Nuk arrin të implementojë objektivat dhe programin vjetor të Odës;
- m. Dështojnë projektet ose nismat për shkak të keqmenaxhimit;
- n. Nuk arrin të mobilizojë Bordin apo administratën në realizimin e qëllimeve strategjike;
- o. Nuk ka koordinim efektiv mes organeve të Odës;
- p. Oda përballlet me ngecje funksionale për shkak të drejtimit të dobët.

NENI 4

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E BORDIT

1. Bordi drejtues ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - a. Zgjedhjen e kryetarit të Odës nga radha e anëtarëve të vet,
 - b. Themelimin e komisionit vlerësues dhe komisioneve të tjera siç parashihet me normative,
 - c. Hartimin dhe propozimin e Statutit të Odës, Kodit Etik dhe të Sjelljes Profesionale të Odës, Rregulloren për procedurën disiplinore, rregullave dhe procedurave të ankesës si dhe hartimin e akteve të tjera të Odës siç parashihet me këtë ligj dhe me aktet e përgjithshme të Odës,
 - d. Lëshimin dhe marrjen e vulës dhe kartelës identifikuese të arkitektëve dhe inxhinierëve të licencuar,
 - e. Propozimin e vendimeve për çështjet për të cilat vendos Kuvendi,
 - f. Zbatimin e vendimeve dhe akteve të tjera të Kuvendit,
 - g. Mbikëqyrjen e standardeve të punës së anëtarëve të licencuar sipas detyrës zyrtare,
 - h. Kontabilitetin financiar të Odës,

- i. Përgatitjen e buxhetit vjetor të Odës dhe propozimit për miratim në Kuvend, në përputhje me kufizimet dhe detyrimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës,
- j. Me të hyrat e Odës menaxhon Bordi Drejtues dhe Kryetari i Odës, në përputhje me kufizimet dhe detyrimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit,
- k. Përgatitjen e programit për edukimin e vazhdueshëm të anëtarëve të licencuar të Odës,
- l. Përgatitjen e raporteve përkatëse për Kuvendin lidhur me shpenzimet e buxhetit (derisa Oda është në periudhë të përkohshme, ky raportim i bëhet Komisionit Mbikqyrës)
- m. Thirrjen e mbledhjeve dhe propozimin e mbajtjes së zgjedhjeve në Kuvend,
- n. Zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv dhe punonjësve të administratës me konkurs të hapur në pajtim me Ligjin, Statutin, rregulloren e Administratës, si dhe pezullimin e shkarkimin e tyre,
- o. Miratimin e programit vjetor dhe përpilimin e raportit vjetor të Odës,
- p. Dhënien e opinionit për ligjet dhe aktet nënligjore në fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, mbrojtës së mjedisit dhe fushave tjera që ndërlidhen me punën e inxhinierit, si dhe projektligjet, projektaktet nënligjore, apo propozimin e dispozitave ligjore përkatëse,
- q. Vendosjen për lartësinë e kompensimit për shërbimet që ofrohen nga Oda,
- r. Vendosjen për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve për anëtarët e Odës,
- s. Themelimin e komisioneve që janë kompetencë e Bordit, si dhe grupeve punuese, këshillave profesionale dhe grupeve të ekspertëve, si dhe emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të tyre,
- t. Bordi Drejtues i Odës mund të vendos që detyrat e caktuara administrative dhe ligjore të Administratës së Odës të kryhen nga persona juridikë ose fizikë të jashtëm të kontraktuar nga Oda,
- u. Vendos për çështje të tjera të cilat nuk janë kompetencë e organeve të tjera të Odës.

NENI 5
NOMINIMET PËR ZGJEDHJE TË ORGANEVE TË ODËS

1. Sa i përket të drejtës për nominime Bordi drejtues në thirrjet për mbledhje të Kuvendit dhe themelimin komisionit vlerësues me komisione tjera:
 - a. Bordi drejtues shqyrton brenda afatit prej 7 (shtatë) ditë nominimet e pranuar për anëtar të rregullt të Odës apo organet e Odës, nominimet i pranon apo refuzon në bazë të kriterëve të përcaktuara me Statut,
 - b. Lista zgjedhore përfundimtare publikohet nga bordi drejtues, së paku shtatë (7) ditë para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit për zgjedhjen e organeve të Odës. Nominimet në listën zgjedhore renditen sipas datës dhe kohës së nominimit apo duke filluar nga i nominuari i parë.
2. Sa i përket thirrjes për mbledhje të kuvendit, bordi drejtues ka të drejtë dhe obligim:
 - a. Bordi drejtues thërret mbledhjet e rregullta të kuvendit së paku një (1) herë në vit.
 - b. Bordi drejtues ka të drejtë të thërras mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendit në rrethana të jashtëzakonshme me një apo më shumë pika të diskutimit të çështjeve të natyrës urgjente.
 - c. Bordi drejtues përmes administratës i njofton të gjithë anëtarët e Kuvendit, të paktën njëzet e një (21) ditë para datës së caktuar për mbledhje të rregullt dhe të paktën dhjetë (10) ditë para datës së caktuar për mbledhje të jashtëzakonshme.
 - d. Një Anëtar i Bordit drejtues i autorizuar kryeson mbledhjet e kuvendit në mungesë të Kryetarit të Odës.
 - e. Me rastin e thirrjes së Kuvendit nga ana e Bordit drejtues, bordi drejtues mund të thërret kuvendin edhe përmes ndonjë platforme elektronike të njohur për videokonferenca.
 - f. Kryetari mund të zgjedh ndonjë prej formave elektronike sa i përket mënyrës së fshehtë të votimit nga ana e Snëtarëve të Kuvendit.
 - g. Kjo mënyrë e votimit do të jetë pjesë e procesverbalit që do të mban kryetari apo i autorizuar prej tij.
 - h. Përgjegjësia e bordit drejtues për themelimin e komisionit vlerësues dhe komisioneve tjera.
 - i. Bordi drejtues i Odës themelon komisionin vlerësues i cili do të jetë përgjegjës për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për aplikimet për lincencimin e inxhinierëve.
 - j. Bordi drejtues themelon komisione tjera të nevojshme për përmbushjen e përgjegjësi të bordit të përcaktuara me normative.

3. Komisionet e themeluara sipas paragrafëve të lartcekura përbëhen nga anëtarët e bordit drejtues, nuk ju lejohet kompensim shtesë për shkak të punës në komisionet dhe të njëjtat për punën e tyre i raportojnë bordit drejtues.

NENI 6

ANËTARËT E BORDIT DREJTUES

1. Anëtarët e Bordit janë të obliguar që të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit, me përjashtim të rasteve kur për arsye objektive dhe me njoftimin paraprak tek Kryetari, nuk mund të jenë të pranishëm.
2. Anëtarët e Bordit paraqesin propozime për çështje që janë në kompetencën e bordit dhe kontribuojnë me përgjegjësi në plotësimin e detyrave që i ngarkohen.
3. Anëtarët e Bordit kanë detyrim të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të mos pengojnë zbatimin e politikave, të vendimeve ose veprimeve ligjore të bordit apo autoriteteve të tjera drejtuese.
4. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, anëtarët e bordit duhet të shmangin konfliktin e interesave të tyre private me ato publike.
5. Kryetari dhe anëtarët e bordit drejtues nuk mund të mbajnë pozita udhëheqëse në organizata joqeveritare, publike apo politike.

NENI 7

KONFLIKTI I INTERESIT

1. Anëtarët e Bordit Drejtues janë të obliguar të veprojnë në interes të OIRK-së dhe të shmangin çdo situatë që paraqet konflikt interesi personal, profesional apo financiar.
2. Anëtari i Bordit që ka ndonjë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në një çështje që shqyrtohet nga Bordi, duhet ta deklarojë këtë konflikt dhe të përmbahet nga pjesëmarrja në diskutim apo vendimmarrje për atë çështje.
3. Deklarimi i konfliktit të interesit bëhet me shkrim dhe i dorëzohet Kryetarit të Bordit para mbledhjes ose në momentin kur konflikti identifikohet.
4. Bordi Drejtues regjistron të gjitha rastet e deklaruara të konfliktit të interesit në procesverbalin përkatës të mbledhjes.

5. Mosdeklarimi i konfliktit të interesit përbën shkelje të rëndë të etikës dhe mund të rezultojë me masa disiplinore, përfshirë propozimin për shkarkim.
6. OIRK miraton formular standard për deklarimin e interesave personale dhe profesional të anëtarëve të Bordit, i cili plotësohet në fillim të mandatit dhe përditësohet çdo vit ose sa herë që ndryshojnë rrethanat.

NENI 8

MBLEDHJET E BORDIT

1. Bordi mbledhet të paktën gjashtë herë në muaj në përmbushje të detyrave të përcaktuara. Bordi mund të mbledhet edhe më shpesh në varësi të çështjeve që kërkohet të shqyrtohen për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të Odes.
2. Mbledhja e Bordit drejtohet nga Kryetari; në mungesë të tij, ajo drejtohet nga anetari i bordit i autorizuar nga Kryetari.
3. Mbledhja e Bordit konsiderohet e vlefshme kur marrin pjesë të paktën katër anëtarë me të drejtë vote. Kjo prezencë është e mjaftueshme për zhvillimin e punimeve dhe procesin e votimit. Në rast se nuk plotësohet kuorumi, Kryetari e shtyn mbledhjen për një datë tjetër, e cila duhet të jetë së paku 48 orë pas mbledhjes së pare.
4. Si rregull, mbledhjet e Bordit zhvillohen në ambientet e OIRK, përveç rasteve kur Bordi vendos ndryshe.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES

1. Mbledhjet e Bordit thirren me nismën e Kryetarit ose me kërkesën e dy anëtarëve të Bordit. Në këto raste, mbledhja organizohet jo më vonë se 7 ditë pas kërkesës së paraqitur prej tyre.
2. Kryetari vendos për datën, kohën e mbledhjeve të radhës dhe njoftimin e anëtarëve jo më vonë se 5 ditë përpara mbledhjes. Rendi i ditës u njoftohet anëtarëve jo më vonë se 2 ditë para mbledhjes.
3. Mbledhja e Bordit thirret duke komunikuar kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes, duke dërguar anëtarëve materialet e mbledhjes për shqyrtim.

4. Lajmërimi për mbledhjen dërgohet nga kryetari i OIRK-së në formë elektronike, në adresat zyrtare të Anëtarëve të Bordit. Si datë e lajmërimit do të konsiderohet data kur ai është dërguar në rrugë elektronike.
5. Anëtari i Bordit, si rregull, konfirmon marrjen e lajmërimit ose njofton për mungesën e pjesëmarrjes, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune para datës së mbledhjes.

NENI 10

UDHËHEQJA E MBLEDHJEVE DHE MARRJA E VENDIMEVE

1. Vendimet e Bordit merren me shumicë të thjeshtë dhe me votim të hapur të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga kjo rregullore.
2. Mbledhjet e Bordit, sipas kësaj rregulloreje i udhëheq Kryetari i Bordit, ose në mungesë të tij, njeri nga anëtarët të cilin e cakton kryetari i bordit.
3. Para fillimit të mbledhjes, kryetari, vërteton numrin e anëtarëve, që janë të pranishëm dhe të atyre që mungojnë, dhe i njofton të pranishmit për pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve në mbledhje, ku mund të merren vendime meritore.
4. Kryetari i Bordit e hap mbledhjen, duke pyetur të pranishmit se a pajtohen me rendin e ditës të propozuar për atë mbledhje. Pas caktimit të rendit të ditës, fillon mbledhja sipas pikave të rendit të ditës.
5. Anëtari i Bordit mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë mbledhjes, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi për OIRK-nw.
6. Anëtarët e Bordit marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, mund të kërkojë informacione shtesë, shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit.
7. Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës bëhet veç e veç, sipas rregullit, së pari në parim e pastaj në veçanti.
8. Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryetari. Kryetari mund të propozojë, që koha e shqyrtimit të zgjatë jo më shumë se 3 deri në 5, minuta.
9. Kryetari i Bordit duhet t'i përmbahet parimit të barabarësisë së anëtarëve të Bordit dhe duhet që të gjithëve t'iu mundësojë pjesëmarrje të barabartë në diskutim.

10. Askush nuk mund ta marrë fjalën në diskutim para se t'ia japë fjalën kryetari, t'i ndërhyjë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë të pengojë punën e mbledhjes.
11. Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve.
12. Kryetari i Bordit mbyll diskutimin dhe propozon, që të kalohet në propozimin e radhës si pas rendit të ditës.
13. Në bazë të propozimeve në material dhe mendimeve të shprehura gjatë diskutimeve, Kryetari i Bordit formulon konkluzionet dhe ato i paraqet për votim.
14. Gjatë marrjes së vendimeve, votimi bëhet me ngritje të dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numërim.
15. Propozimi konsiderohet i miratuar, nëse për atë deklarohen me shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit të Drejtues që janë të pranishëm.
16. Para votimit, çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve, ka të drejtë ta veçojë votimin apo abstenimin dhe që kjo çështje të shënohet në procesverbal.
17. Në rastin kur rezultati i votimit është i barabartë, atëherë vota e kryetarit është përcaktuese.
18. Nëse çështjet e rendit të ditës nuk arrijnë të shqyrtohen brenda ditës së mbledhjes, ai vendos vazhdimin e mbledhjes në një ditë tjetër ose përfshirjen e çështjeve në mbledhjen e ardhshme të Bordit.
19. Në fund të mbledhjes Kryetari i Bordit bën një përmbledhje të shkurtër të çështjeve të diskutuara dhe vendimeve të marra dhe më pas, deklaron mbylljen e saj. Në rast të mungesës së kryetarit të Bordit, përmbledhja bëhet nga i deleguari i Kryetarit.

NENI 11

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

1. Në çdo mbledhje të Bordit hartohet procesverbali, i cili përmban datën dhe vendin e mbledhjes, Anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe formën dhe rezultatin e votimeve.
2. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e Bordit Drejtues,
3. Procesverbali aprovohet në mbledhjen vijuese të bordit drejtues, pas aprovimit nënshkruhet nga Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e procesmbajtësit.

4. Procesverbali formal me shkrim do të nënshkruhet nga kryetari i OIRK-se që e ka kryesuar mbledhjen dhe nga personi që ka shërbyer si sekretar në mbledhje.

NENI 12

PJESEMARRJA NE MBLEDHJE

1. Anëtarët e Bordit drejtues kanë për obligim të marrin pjesë në mbledhje dhe të jenë të përgatitur për çështjet për të cilat do të diskutohet.
2. Mungesa e Anëtarëve të Bordit drejtues duhet arsyetuar, mos arsyetimi i tri mungesave nga anetari I bordit në mbledhje, do të procedohet sipas rregullorës në fuqi për disiplinën.
3. Gjatë diskutimeve për pikat e rendit të ditës, Anëtarët e Bordit shqyrtojnë të gjitha çështjet në mënyrë të arsyeshme duke diskutuar sipas rendit të ditës së aprovuar.
4. Pas prezantimit të rendit të ditës Anëtarët e Bordit mund bëjnë plotësimin apo ndryshimin e rendit të ditës.

NENI 13

AUTORIZIMI I SHPENZIMEVE

1. Kryetari bën autorizimin e shpenzimeve nga buxheti i Odës, në përputhje me kufizimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Statuti i Odës dhe aktet e brendshme të miratuara për periudhën e përkohshme të funksionimit të Odës.
2. Autorizimi individual nga Kryetari nuk mund të tejkalojë vlerën mujore të përcaktuar me procedurat e ekzekutimit të buxhetit për periudhën e përkohshme, përveç nëse miratohet ndryshe nga Bordi Drejtues.

NENI 14
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen në të njëjtën mënyrë sikurse në procedurën e aprovimit.
2. Çështjet të cilat nuk janë definuar në këtë Rregullore, trajtohen drejtpërdrejtë sipas dispozitave ligjore të ligjit për Odat e Arkitekteve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit dhe statutit të OIRK-së.

NENI 15
HYRJA NË FUQI

Rregullorja e Punës së Bordit Drejtues të OIRK-së hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Bordi Drejtues

Prishtinë
Më 08.07.2025

Arsim Rapuca,
Kryetar i OIRK-së

